

**Ndikimet e migrimit të shqiptarëve në vendlindjen e tyre
Tetovë**

**Një hulumtim kualitativo-eksplorativ në rajonin e Tetovës
(Maqedoni)**

Përmbledhje e raportit përfundimtar

Lucern, Dhjetor 2009

Gülcan Akkaya

Bernhard Soland

Hyrje

Studimi i paraqitur ekzaminon ndikimet e mërgimit të popullatës shqiptare të Tetovës/Maqedonisë në regjionin e tyre prejardhës. Ky studim poashtu parashtron çështjen, se si kanë ndryshuar perspektivat jetësore individuale të popullatës së studjuar nga ndikimi i migrimit.

Ndikimet e migrimit analizohen sipas pikave kyçe në fushën e ekonomisë, dijenisë dhe njohurisë profesionale/ Know-how si dhe sipas aspekteve socio-kulturore.

Emigrantët tetovarë që jetojnë në Zvicër transferojnë në vendlindje forma të ndryshme të resurseve apo burimeve ekonomike. Një pjesë e rëndësishme e këtyre resurseve rrjedh në formë të transferimit të parave apo të pronave materiale për përkrahjen direkte të anëtarëve të familjeve.

Mirëpo gjithashtu transferohen edhe informacione, dijeni, njohuri profesionale/Know-how dhe arsimim.

Në rajonin nga e kanë prejardhjen emigrantët, paratë e transferuara përdoren për konsum, për ndërtimin e shtëpive si dhe për përkujdesjen shëndetësore dhe arsimimin e anëtarëve të familjeve. Emigrantët e kthyer përgjithëmonë në vitet e fundit kanë themeluar shumë ndërmarrje të vogla në Tetovë.

Në Tetovë tani është tejet e kerkuar dijenia dhe njohuria profesionale/Know-how e përvetësuar në Zvicër në fushën profesionale të zejtarisë.

Qarkullimi i parave nuk e rrit vetëm fuqinë e blerjes në rajon, por gjithashtu përpos largesës hapsinore transferet i mbajnë gjallë lidhjet familjare, kështuqë lind një lidhje e gërshetuar ndërnacionale.

Autorët

Gülcan Akkaya, udhëheqëse e projektit / Docente në Universitetin e Lucernit- Punë Sociale
Bernhard Soland, asistent akademik në Universitetin e Lucernit- Punë Sociale

Falemnderim

Ky studim u zbatua në bashkëpunim me direksionin për zhvillim dhe bashkëpunim DEZA, pa ndihmën financiare të cilëve nuk do të ishte fare i zbatueshëm. Posaçërisht i falemnderohemi Brigitte Hagmann dhe Alfred Fritschi nga udhëheqësia e Seksionit Balkani Perëndimorë.

Më tutje i falemnderohemi Georgette Bruchez Brugger, përgjegjësen e dikurshme të projektit të Direksionit për zhvillim dhe bashkëpunim (DEZA) për Maqedoni.

Falemnderimin tonë të posaçëm ua kushtojmë personave të intervjuar, anëtarëve të familjeve të emigrantëve dhe emigrantëve të kthyer në vendlindje, si dhe personave kyç, për gadishmërinë dhe besimin e tyre të flasin për historitë e jetës së tyre dhe të raportojnë për jetën e përditëshme në migrim. Te gjithë ata na dhanë neve shikime të rëndësishme dhe mbresëlënëse nga jeta e tyre.

Posaçërisht i falemnderohemi Vlora Bajramit. Ajo ka udhëhequr shumicën e intervistave, ka vendosur kontakte me popullatën e studijuar, përktheu, transmetoi dhe organizoi takime. Diskutimet e denja me të, dijenia e saj, idetë dhe propozimet e saja ishin jashtzakonisht të rëndësishme për studimin. Pa ndihmën dhe përkrahjen e saj do të ishte pamundur të realizoheshin intervistat.

Poashtu Alida Emini dhe Jehona Ibraimi udhëhoqën disa intervista, për përkrahjen e tyre kompetente gjithashtu ju falemnderohemi. Sharon Kroskës i falemnderohemi për përkthimet dhe diskutimet inkurajuese.

Për sygjerimet me përmbajtje të rëndësishme në fazat e ndryshme të studimit, falemnderimin tonë të posaçëm ua drejtojmë personave që vijnë: Walter Schmid, Rektor në Universitetin e Lucernit – Punë sociale (HSLU-SA); Nexhbedin Beadini, rektori i dikurshëm dhe sot profesor në Universitetin Shtetërorë të Tetovës; Romain Darbellay, udhëheqësi i dikurshëm i byrosë për kooperim të direksionit për zhvillim dhe bashkëpunim DEZA në Shkup; Trpe Stojanovski, drejtor i MARRI "Migration, Asylum, Refugees Regional Initiative"; Toni Jakimovski, nëpunës shtetërorë në Republikën e Maqedonisë në MARRI "Migration, Asylum, Refugees Regional Initiative"; Jorde Jakimovski, udhëheqës i Institutit për Shkencat politike dhe Sociale në Universitetin „Shën Kirili dhe Metodij“ në Shkup; Murtezan Ismaili, Prorektor për Hulumtim në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë; Janine Dahinden, Udhëheqëse dhe profesoreshë ordinare pranë MAPS (Maison d'analyse des processus sociaux) në Universitetin Neuchâtel; Susanna Niehaus, Udhëheqëse e mbështetjes për hulumtim në Universitetin e Lucernit HSLU-SA; Fernanda Benz, Bashkëpunëtoreshë akademike në Universitetin e Lucernit HSLU-SA dhe Emanuel Müller, HSLU-SA.

Dhe më në fund duam të falemnderojmë Tatjana von Steiger Weber, udhëheqësen e byrosë për kooperim në Direksionin për zhvillim dhe bashkëpunim- DEZA në Shkup, si dhe bashkëpunëtorëve të byrosë për kooperim, në përkrahjen dhe organizimin e takimeve dhe mbledhjeve.

Abstrakt

Emigrantët e ish Jugosllavisë e formojnë grupën e dytë më të madhe të emigrantëve në Zvicër. Gati 55'000 të këtyre emigrantëve janë pjesëtarë të pakicës shqiptare nga Maqedonia. Për Maqedoninë, respektivisht për rajonin e Tetovës, nga i cili rajon rrjedh një pjesë e madhe e emigrantëve, ky grup i popullatës ka një rëndësi tepër të madhe para së gjithash për përkrahje të rajonit nga i cili vijnë.

Studimi i parashtruar i Universitetit të Lucernit- Punë Sociale shqyrton ndikimin e emigrantëve shqiptarë të Zvicrës, në vendlindjen e tyre në Tetovë. Për të kuptuar dhe analizuar më mirë ndikimin e ndërsjellë të migrimit në Tetovë, u zhvilluan 44 intervista me anëtarë të familjeve të emigrantëve, me emigrantët e kthyer në vendlindje si dhe me persona kyç të rajonit. Çështja e këtij studimi orientohet sipas koncepteve relevante të *ndërnacionialitetit* dhe *remitancave* në hulumtimin e migrimit. Emigrantët transferojnë në vendlindjen e tyre në fusha të ndryshme ndërnacionale jo vetem para, por gjithashtu edhe burime të tjera ekonomike si dhe resurse-remitanca të tjera potenciale, kyçe për zhvillim. Këto remitanca mund të klasifikohen në *resurse ekonomike, dijeni dhe njohuri profesionale si dhe resurse socio-kulturore*. Në përputhje me këtë klasifikim, studimi kualitativ dhe eksplorativ i ndërtuar në plan të gjërë analizon rrjedhën e resurseve, dhe ndikimet në rajonin e Tetovës në *fushën ekonomike, në fushën e dijenisë dhe në fushën e ekspertizës profesionale si dhe në fushën socio-kulturore*.

Për shkak të karakterit eksplorativ studimi tematizon në bazë të intervistave të regjistruara, aspekte të ndryshme prapavepruese të migrimit. Në sferën ekonomike migrimi ka ndikim direkt, veçanërisht në ekonominë familjare në transferimin e parave dhe këtyre familjeve të rajonit u mundëson një standard jetësor mbimesatarë. Ekonomia rajonale përfiton në mënyrë selektive nga resurset ekonomike të emigrantëve. Shumë kapital rrjedh në sektorin e ndërtimitarisë dhe themelimi i firmave të reja (industri furnizuese ndërtimi) shpien në gjallërimin e ekonomisë së shtresës së mesme. Me konsumin e nxitur nga rrjedha financiare përfitojnë në një shkallë të caktuar edhe lokalet edhe restorantet. Në përgjithësi emigrantët investojnë pak dmth. Investojnë njëanshëm në ekonominë rajonale të Tetovës. Për shumicën një ndër investimet më të sigurta të parave është ndërtimi i një shtëpie banimi, se sa investimi që është më me rrezik në ndonjë ndërmarrje vetanake apo të huaj.

Në përgjithësi në rajonin e Tetovës shumë të ralla janë transferet e burimeve në fushën e dijenisë dhe njohurisë profesionale. Transferimi i njohurive profesionale bëhet vetëm atëher, kur emigrantët që kthehen në vendlindje fillojnë një biznes apo kur gjejnë një vend pune në ndonjë ndërmarrje rajonale. Rajoni përfiton nga aftësitë praktike të njohura këtu dhe nga kuptimi zvicran për punë, që emigrantët e kthyer në vendlindje - me kualifikim minimal- i kanë përvetësuar gjatë ushtrimit të punës së tyre në ndërmarrjet Zvicërane.

E rrallë është rrjedha e kundërt dhe transferi i njohurisë profesionale me kualifikim të lartë nga Zvicra në Tetovë.

Potenciali ekzistues posaçërisht tek gjenerata pasardhëse e mërgimtarëve tetovarë pothuajse aspak nuk mundet të shpalos ndikimet e veta. Nga njëra anë një numër i vogël i këtyre të rinjëve janë të motivuar të kthehen në Tetovë, nga ana tjetër nuk ekzistojnë pothuajse aspak rrjeta përkatëse ndërnacionale (Kooperaçione Universitare, Platforma-Online etj.) ku do të mundej të bëhej një transfer i dijenisë - mundësisht duke mos u kthyer në vendlindje.

Në fushën socio-kulturore dukshëm vërehen ndikimet e proceseve migruese – edhe atë tek emigrantët si dhe tek të afërmit e tyre. Nga përvojat migruese të bëra në Zvicër konstatohet një ndryshim i dukshëm në stilin jetësor, një ndryshim të roleve në familje si dhe në formimin e paramendimeve të reja jetësore të karakterit ndërnacional.

Hyrje

Që nga vitet e 1960-ta në Zvicër jetojnë pjesëtarë të pakicës shqiptare të Maqedonisë. Mërgimtarët e parë erdhën si punëtorë sezonal. Tani mbrenda këtyre viteve jetojnë në Zvicër tre gjenerata. Një grup i mërgimtarëve shqipëtar nga Tetova qëndrojnë në Winterthur dhe në Zvicrën lindore. Në një interval të gjatë kohor, këtu janë zhvilluar rrejtat shoqërore komunikimi mes emigrantëve në Zvicër dhe anëtarëve të familjeve të tyre në vendlindje. Mërgimtarët këmbëjnë informacione, transferojnë para, dijeni, ekspertizë dhe arsimim, si dhe i përmbajnë anëtarët e tyre të familjes. Nga qëndrimi i gjatë në Zvicër ekziston një lidhje e fortë emocionale me rajonin e tyre prejardhës të Tetovës. Angazhimi për Tetovën ka një rëndësi të madhe për emigrantët. Një rol tejet të rëndësishëm luan mobiliteti dhe dimensionin ndërnacional i migrimit.

1.1 Konteksti dhe çështja e studimit

Në studimin e paraqitur shqyrtohen ndikimet e migrimit të mërgimtarëve shqipëtar në Zvicër në rajonin e tyre prejardhës në Tetovë. Në fokus qëndrojnë nga njëra anë ndikimet ekonomike si dhe ndikimet e rrjedhjes reciproke të dijenisë dhe njohurisë profesionale në rajon. Nga ana tjetër na interesojnë edhe pasojat socio-kulturore si dhe ndryshimet e qëndrimeve dhe planeve jetësore individuale, që nga përvoja e migrimit mund të trashigohen jo vetëm të emigrantët por edhe tek anëtarët e tyre të familjes, në Tetovë.

Rrjetat ndërnacionale sot konsiderohen si burime/resurse, që u mundësojnë emigrantëve nga njëra anë të organizohen në vendin e ardhur, nga ana tjetër me anë të transferit të mallrave dhe shërbimeve të mundësojnë ndihmë ndërnacionale. (Bauer et al. 2000). Këto rrjeta ndërnacionale edhe për të afërmit në vendlindje paraqesin burime/resurse të rëndësishme ekonomike, kulturore dhe sociale. Pothuajse sundon pajtueshmëria shkencore, se rrjetat migruese prezantojnë një formë të kapitalit shoqërorë, kështu që edhe hulumtimi i rrjetit bartet dukshëm në proceset migruese (Dahinden 2005). Në vitet e fundit në një numër të madh të studimeve u shqyrtuan pasojat e lëvizjeve migruese në vendet nga e kanë prejardhjen emigrantët, në vendet tranzite si dhe në vendet strehuese. Hulumtimi aktual i migrimit nisët nga koncepti i fortë i migrimit si një proces ciklik, që është i karakterizuar nga lidhjet shumë shtresore dhe rrjetat mes shumë vendeve dhe më tutje në mes kufijve shtetërore (Glick Schiller et al. 1992). Njerëzit mund të kenë një numër të madh të lidhjeve dhe bashkëveprimeve në disa vende, me anë të cilëve lindin fusha dhe rrjeta ndërnacionale shoqërore (krahaso Pries 2008).

Akoma në vitet e 1970-ta dhe 1980-ta në diskutet shkencore u konsiderua migrimi për vendet prejardhëse më tepër si pengesë, se sa si i dobishëm për zhvillim. Megjithatë që nga vitet e 1990-ta këtu konstatohet një trend i vlerësimit pozitiv. Në vitet e fundit u transferuan dukshëm ndikimet pozitive në proceset zhvilluese në rajonet prejardhëse, posaçësisht nga transferimi i parave apo deponim në bankë- i të ashtuquajturave remitanca të emigrantëve (krahaso kapitullin 2.2).

Në studimin e parashtruar termi remitanca është i formuluar gjërë dhe përmban të gjitha llojet e burimeve/resurseve të transeferuara nga ana e emigrantëve në vendlindjet e tyre. Këto resurse klasifikohen në resurse ekonomike (ndër të tjera remitanca financiare), dijeni dhe njohuri profesionale si dhe resurse socio-kulturore (krahaso Faist 2008, de Haas 2005, Levitt 1998, Levitt und Nyberg-Sørensen 2004).

Në përputhje me këtë analizohen këtu jo vetem efektet ekonomike të migrimit për vendet prejardhëse, por gjithashtu edhe ndikimet e migrimit në fushën socio-kulturore si dhe në fushën e dijenisë dhe njohurisë profesionale. Kuantifikimi i rrjedhës reciproke nuk qëndron në qendër të vëmendjes, më shumë duhet të evidentohen dhe përshkruhen në kompleksitetin e tyre aspektet e ndryshme të ndikimit të migrimit në rajonet prejardhëse.

Pyetjet ekzaminuese qendrore të studimit janë:

- Cilat ndikime i ka migrimi i popullatës shqiptare në rajonin e tyre prejardhës Tetovë në fushën e ekonomisë, arsimit, kontekstit socio-kulturor si dhe në lidhje me perspektivat jetësore individuale të popullatës së studijuar?
- Si apo në çfarë mënyre ndodhin rrjedhjet reciproke të burimeve/resurseve?

Më tutje bëhet fjalë për përdorimin më të mirë të burimeve/resurseve, të cilat në Tetovë arrijnë nga migrimit. Këtu interesimi nuk ka të bëjë vetëm me rrjedhjen reciproke në pikëpamjen ekonomike, por gjithashtu edhe me faktorët e „butë“, si influenca e proceseve migruese në lidhjet shoqërore dhe qëllimet jetësore personale të anëtarëve të familjeve të mbetura në vendlindje dhe të emigrantëve të kthyer përgjithmonë.

- Çfarë domethënie ka migrimi për anëtarët e familjeve të emigrantëve „të mbetur“ në vendlindje?
- Çfarë domethënie ka ai për emigrantët e kthyer përgjithmonë në vendlindje?
- Cilat janë efektet dhe ndikimet në rajonin prejardhës të Tetovës në përgjithësi nga migrimi i një grupi të tërë të popullatës shqiptare që jetojnë në Zvicër?

Për ta kuptuar domethënien prapavepruese të migrimit nga lidhja e ndërsjellte jetësore e secilit, u zhvilluan në vend- në Tetovën e Maqedonisë- me 44 persona intervista kualitative. Grupi i personave të intervjuar përbëhej nga anëtarët e familjeve të emigrantëve, të emigrantëve të kthyer përgjithmonë si dhe prej personave bartës të përgjegjësisë shoqërore dhe ekonomike/ persona kyç.

Me qëllim që të përfitohen vështrime të thella të aspekteve të ndryshme të rrjedhjes reciproke të migrimit në rajonin prejardhës, ky studim don të arrijë një kontribut me anë të këtij hulumtimi për diskutimet aktuale për ndikimet e migrimit në vendet prejardhëse. Ky studim merret me çështjen, që deri tani rrallë është shqyrtuar dhe sa i përket grupës emigruese të Tetovës fare nuk është shqyrtuar. Me këtë, ky shqyrtim është një ekzemplar dhe për Zvicrën i vetmi studim.

Për shkak të aprovimit dhe këshillave për veprim nga institucionet e përmendura më posht, ky studim ka vlerë të lartë praktike dhe shkencore si për institucionet pjesëmarrëse- Direkcioni për bashkëpunimin për zhvillim e byrosë për kooperim DEZA në Shkup, Qendra rajonale MARRI, tre Universitetet pjesëmarrëse (Instituti për hulumtime sociale dhe politikë sociale i „ Universitetit Shën Kirili dhe Metodij në Shkup“, Universiteti Shtetëror i Tetovës si dhe Universiteti i Evropës Juglindore), Ministria e ekonomise në Shkup, Enti për ekonomi në Tetovë, për këshillin e Tetovës- ashtu edhe për opinionin e interesuar. Studimi nuk ka vetëm për qëllim të kontribojë që të kuptohen më mirë proceset migruese dhe për përkrahjet adekuate dhe ndjekjet e tyre, por gjithashtu ka për qëllim para se gjithash ti përsos marrëveshjet politike dhe ekonomike në fushën që ka të bëjë me çështjet zhvillim, migrim dhe integrim.

2 Përmbledhje

Studimi i paraqitur ka patur për qëllim të studijoj ndikimet e migrimit të popullatës shqipëtare në rajonin prejardhës të Tetovës si dhe në perspektivat jetësore individuale të popullatës së studijuar. Si pika kyçe u analizuan fusha e ekonomise, dijenise dhe njohurive profesionale si dhe aspektet sociokulturore. Në bazë të kësaj prapaskene u evidentuan dhe u përshkruajtën ndikimet e migrimit dhe kompleksiteti i tyre.

Duke i marrë në pyetje emigrantët e kthyer në vendlindje, të afërmit e tyre si dhe ekspertët rajonal politik dhe ekonomik dhe komisionet shoqërore, u analizua se në çfarë mënyrë rjedhin burimet/resurset mbrenda dhe jashta rajonit të Tetovës dhe si ndikojnë këto transefre burimesh/resurset individualisht dhe në rajon.

2.1 Fusha ekonomike

2.1.1 Cilat burime/resurse rrjedhin në Tetovë?

Emigrantët tetovarë që jetojnë në Zvicër transferojnë forma të ndryshme të burimeve/resurseve ekonomike në vendlindjen e tyre. Një pjesë e madhe a këtyre burimeve rrjedh në formë të transferimit të parave (remitanca) apo në formë të mallrave materiale për mbështetje direkte të anëtarëve të familjeve të tyre.

Në vitin 2006 me anë të kanaleve bankare në Maqedoni janë transferuar nga mbarë bota remitanca me shumë prej 267 milion Dollarë Amerikane. Vlerësimet e përafërta supozojnë se vlera/shuma efektive qëndron më larte të paktën për 50%, ngase një pjesë e madhe e parave transferohet në Maqedoni me anë të kanaleve jo formale (ndër të tjerash sjellja e parave personalisht). Emigrantët tetovarë që jetojnë në Zvicër dhe që i përmbajnë familjet e tyre financiarisht, në vit transferojnë, në rastet e shumta shumë për mbështetje financiare prej përafërsisht 2000 dhe 6000 Franga Zvicërane. Anëtarët e familjeve pranojnë edhe mbështetje të tjera nga Zvicra në forma të ndryshme të mallrave materiale (ndër të tjerash aparate për shtëpi, por gjithashtu edhe produkte të cilësisë së lartë, si rrobe, artikuj kozmetike). Ekziston arsyeja për të supozuar se në të ardhmen mbështetjeja financiare ekonomike nga Zvicra do të zvoglohet.

Kjo ndodh ndër të tjerash për atë arsye, se që kur shumica e emigrantëve i morren familjet e tyre me vete, ngelen shumë pak para për remiatnca për anëtarët e tjere të familjes në Tetovë.

Shumë kapital nga Zvicra rrjedh në Tetovë, në atë mënyrë që emigrantët në rajonin e tyre prejardhës blejnë shtëpi dhe banesa apo i ndërtojnë vetë ato. Gjatë qëndrimit të emigrantëve në Tetovë arrijnë atje edhe valuta të tjera, një pjesë përafërsisht për harxhimet e larta në restorante dhe lokale të vendit. Një tjetër potencial i burimeve më pak të tematizuara për komunën e Tetovës janë kërkesat për sigurim dhe pension nga emigrantët të dikurshëm të kthyer nga Zvicra. Varësisht nga ajo se sa shpesh dhe sa rregullisht emigrantët kanë paguar për sigurim, ashtu dallojnë edhe shërbimet efektive. Një formë tjetër të burimeve/resurseve e përbëjnë huadhëniet pa kamatë të emigrantëve anëtarëve të tyre të familjeve apo shokëve vetëm për hapjen e ndonjë ndërmarrjeje, apo për ndërtim, apo edhe renovim të shtëpise.

2.1.2 Me anë të cilëve rrugë rrjedhin këto burime/resurse në Tetovë?

Emigrantët shfrytëzojnë rrugë të ndryshme për transferimin e burimeve/resurseve. Bankat, bankat postare si dhe ndërmarjet profesionale për transferim të parave janë kanale formale. Dorëzimi personalisht apo sjellja me anë të farefisit, miqëve, shofer autobusi e tjerë, nënkuptohen si kanale jo formale

Emigrantët tetovarë që jetojnë në Zvicër duket se gjatë transferimit të parave ende përqëndrohen bindshëm te kanalet jo formale, ndër të tjerash, për atë arsye se në rajonet të zhvilluara dobët këto kanale për transferime janë më të volitshme dhe më mire të përshtatshme.

Sot ekzistojnë më shumë mundësi për transferime formale se sa para disa viteve, mirëpo për këtë, pjesërisht nuk janë të informuar sa duhet emigrantët dhe pranuesit. Veç kësaj për arsye të përvojave të këqia në të kaluarën shumica e tetovarëve/eve nuk kanë besim në sistemin bankar maqedonas. Më tepër besim kanë në bankat e huaja, si p.sh. Pro Credit Bank apo Reiffeisen- Bank. Mirëpo që kur Maqedonia është bërë kandidatë për hyrje në BE, duket se është zvogluar skepticizmi ndaj institucioneve (financiare) të Maqedonisë, gjë që tregohet në rritjen e rrjedhjes së remitancave me anë të kanaleve oficiale. Krahas bankave janë themeluar edhe ndërmarje profesionale për transferim të parave. Ndonëse taksat janë të larta, për shkak të funksionuarit të thjeshtë dhe transferimit të shpejtë kjo formë e transferimit të parave është tejet e përhapur.

2.1.3 Përdorimi i burimeve/resurseve

Një pjese e madhe e shpenzuesve të parave të transferuara janë vetë anëtarët e familjeve të emigrantëve. Rallë dërgojnë emigranët tetovarë para në qarqe të vogla si p.sh miqëve, shokëve, apo japin donacione për projekte sociale dhe infrastrukture.

Shpenzuesit shtëpiak i përdorin paratë e transferuara në rradhë të parë për nevojat e tyre të shtëpiake. Me këto para ndër të tjerash bëhet pagesa e llogarive mujore të energjisë elektrike, ujit, telefonit si dhe blerja e ushqimit. Financohen edhe harxhimet për sanitari si dhe për produkte „luksoze“ si celularë, rroba me marka të famshme etj. Investohen para për mbështetje të arsimimit apo edhe të pushimeve familjare.

Gjithashtu një përdorim i përhapur i burimeve/resurseve ekonomike të emigrantëve është blerja e një prone apo ndertimi i një shtëpie banimi.

Një pjesë e emigrantëve kapitalin e tyre e investojnë në ekonomine e rajonit të tyre prejardhës. Në qytetin e Tetovës dhe vendet që shtrihen afër, Xhepcisht dhe Poroj shumë emigrant pas kthimit të tyre kanë themeluar ndërmarrje private. Zakonisht kanë sukses ndërtimet e ndërmarrjeve në ato fusha profesionale, që emigrantët kanë punuar në Zvicër. Tejet të përhapura janë themelimet e ndërmarrjeve në sektorin e ndërtimtarisë (ndër të tjerash prodhimi i materialeve për ndërtim, ndërmarrje zejtarie) në prodhimin e mobiljeve dhe në gastronomi (restorane, hotele).

2.1.4 Ndikimet e remitancave në rajonin e Tetovës

Remitancat tregojnë ndikime direkte dhe kuptimplote ndaj *ekonomisë shtëpiake*. Për një pjesë të shpenzuesëve të ekonomisë shtëpiake këto remitanca e përbëjnë të vetmin burim të ardhurave me rëndësi dhe me këtë ju financohen shpenzimet jetësore. Disave këto remitanca ju mundësojnë standard të tillë jetësore, që qëndron mbi atë të shumicës së familjeve në Tetovë. Me një shqyrtim të situatës financiare të emigrantëve të kthyer përgjithmonë shihet, se mërgimi për ato dhe për familjet e tyre në të shumtat e rasteve ka ndikuar pozitivisht. Nga disa ekspert rajonal si problematike konsiderohet ajo, se shpenzuesit e ekonomisë shtëpiake pjesërisht bëhen të mvarur nga pagesat e mbështetura nga jashtë. Kjo shpjen deri aty të mos ndiqen konsekuent qëllimet jetësore personale.

Transferimi i burimeve/resurseve ekonomike me anë të emigrantëve ka ndikime në ekonominë lokale dhe rajonale, edhe atë gati në të njejtat përmasa sa edhe në nivelin shtëpiak privat. U konstatuan konsum i lartë dhe me këtë edhe ritja e xhiros/qarkullimit për ndërmarrjet lokale, një rrjedhje e ritur e kapitalit në sektorin e ndërtimtarisë, si dhe krijimi i vendeve të punës me anë të themelimit të bizneseve nga ana e emigrantëve të kthyer përgjithmonë.

Megjithatë lidhur me rrethin e ndikimit dhe qëndrueshmërinë e këtyre burimeve/resurseve të transferuara, ekspertët rajonal tërheqin vëmendjen për disa pika kritike. Me sa duket nga njëra anë burimet/resurset ekonomike të emigrantëve nuk kanë një ndikim ekonomik në tërë rajonin e Tetovës, por më tepër në formë selektive, ngase në pak vende haset ky ndikim (krahaso vendet Tetovë, Poroj dhe Xhepcisht), ndërsa vendet tjera janë të prekura nga një shpërngulje masive, me arratisje nga vendi. Pabarazitë shfaqen edhe mes familjeve të emigrantëve dhe familjeve të cilat nuk kanë mbështetje nga jashtë. Për një vështrim kritik ka nevojë edhe aspekti i qëndrueshmërisë së përdorimit të burimeve/ resurseve. Përdorimi për ndërtimin e shtëpise dhe për konsumimin e përditshëm e gjallërojnë ekonominë për aq kohë, sa do të transferojë emigranti para nga Zvicra në rajon. Kjo varësi nuk është joproblematike, ngase në të ardhmen duhet llogaritur me një rënie të rrjedhjes së burimeve/resurseve. Ekspertët premtajnë qëndrueshmëri në investimet e shtuara në ekonominë lokale, si p.sh. me themelimin e firmave nga ana e emigrantëve. Ndërmarrjet e reja duhet më tepër të orinetohen në eksport, që në këtë mënyrë lidhjet, tanimë ekzistuese profesionale apo tregtare me Zvicrën, të mbahen në fuqi apo të mundën të ndërtohen lidhje të reja.

Gjithësesi nuk guxon të mbivlerësohen kapacitetet e emigrantëve. Shumica e emigrantëve nuk disponojnë as me shumë kapital që të mundën ta investojnë, as me dijeni apo përvojë në ndërtimin e lidhjeve tregtare.

Për më tepër nuk guxon të shpërfilllet, se në Maqedoni dhe Tetovë në përgjithësi kushtet/rrethanat kornizë për investitorët janë të vështira. Proçeset e stërzgjatura burokratike dhe korrupsioni, si dhe mungesa e sigurisë për investim i frenon akoma ndërmarrësit e huaj me përvojë nga investimet e mëdhaja.

2.2 Arsimim dhe dijeni

2.2.1 Fitimi dhe humbje e dijenisë dhe ekspertizës/ Know-how për Tetovën

Me lëvizjet e mërgimit në të shumtën e rasteve shkojnë tok me ato edhe proçeset transferuese të dijenisë dhe njohjes profesionale, që për rajonin prejardhës mundën të kenë një domethnie edhe si një fitim (*brain gain*) por edhe si një humbje e resurseve/ burimeve (*brain drain*). Me analizën e teksteve migruese „tetovaro-zvicëranë“ u vrojtën lidhur me rajonin prejardhës të Tetovës efekte edhe të *brain gain* edhe të *brain drain*. Mirëpo sot këto dy fenomene marrin vetëm një përmasë të vogël.

Paraprakisht duhet njoftuar këtu, se pjesa dërmuese e gjeneratës së parë të punëtorëve emigrant „klasik“, në kohën e migrimit të tyre kishin një të kaluar me një arsimim të ulët. Vetëm një numër i vogël i personave të kualifikuar mirë e lëshuan vendin në atë kohë. Prandaj nuk mundet këtu të flitet për një *brain drain*. Përkundrazi: Disa punëtorë emigrant mbrenda kohës janë kthyer në Tetovë dhe kontribuojnë për *brain gain* për rajonin e Tetovës, ku transferojnë dijeni profesionale praktike nga Zvicra.

Me gjeneratën e dytë të emigrantëve tetovarë në Zvicër, dmth. me pasardhësit e gjeneratës së parë emigruese janë të lidhura efektet edhe të *brain drain* edhe të *brain gain*. Pjesëtarët e kësaj gjenerate shpesh kanë absolvuar një pjesë apo tërë shkollimin e tyre. Shumë pak njerëz kthehen në Tetovë, për shkak të perspektivës së keqe profesionale dhe rrogave të ulta, mu për këtë arsye në Tetovë rrjedh vetëm një pjesë e vogël e burimeve/resurseve të dijenisë të përfituara në Zvicër. Ekspertët tetovarë e vlerësojnë largimin e të rinjëve nga Tetova si një humbje shoqërore e potencialit të dijenisë.

Jo së fundi që nga vitet e 1990-ta për shkak të ashpërsimit të politikës për azil dhe për tregun e punës në përgjithësi viteve të fundit është zvogluar shumë shpërngulja i Tetovarëve/eve në Zvicër. Kjo vlen gjithashtu edhe për vendet tjera të Europës perendimore. Shumica, para se gjithash të rinjtë e Tetovës ndodhen sot në një situatë të vështirë, edhe pse absolvojnë një kualifikim të mirë arsimorë nuk kanë perspektivë profesionale. Në përputhje me këtë tek të rinjtë është tejet e përhapur synimi për migrim.

Prandaj nuk duhet të nënvlerësohen pasojat, që mundet të shkojnë tok me rritjen e lirisë të zgjidhet vendbanimin sa i përket vlerësimit të përafërt dhe me vonë eventualisht me integrimin e mundshëm në BE. Përkohësisht kjo mund të shpie në shpërngulejn e madhe të Tetovarëve/eve të kualifikuar mirë.

2.2.2 Kryesisht transfer i ekspertizës/Know-how profesionale

Në rajonin e Tetovës me sa duket akoma rezulton nga migrimi mes Tetovës dhe Zvicrës një *brain gain* – megjithëse ekziston, është në përmasa të vogla. Ky *brain gain* ndodh më tepër në qarqet profesionale. Parasegjithash transferohen dy forma të dijenisë dhe njohurisë profesionale: Nga njëra anë njohuri profesionale, dhe lidhur me këtë dijeni mbi organizimin e punës apo organizimin e proceseve të punës.

Kur flitet për njohuri profesionale bëhet fjalë për aftësitë në mjeshtri/zanat dhe aftësi teknike si dhe bëhet fjalë për dijeninë profesionale në përgjithësi, të përvetësuar vite me radhë nga ana e emigrantëve gjatë angazhimit të tyre profesional në Zvicër. Në rajonin prejardhës barten këto burime/resurse të dijenisë më lehtë atëher, kur emigrantët e kthyer përgjithmonë themelojnë atje një ndërmarrje, në të shumtën e rasteve këto ndërmarrje janë të vogla apo të mesme. Zakonisht rregullimi i ndërmarrjeve të reja u përgjigjet fushave profesionale, në të cilat kanë punuar emigrantët në Zvicër. Të përhapura janë themelimet e ndërmarrjeve në sektorin e ndërtimitarisë (ndër të tjerash prodhimi i materialit për ndërtim, ndërmarrje zejtarie), në prodhimin e mobiljeve dhe në gastronomi (restorante dhe hotele). Emigrantët e kthyer përgjithmonë përcjellin tashmë një njohuri mbi organizimin e punës dhe proceseve të punës si dhe njohuri mbi njëfar etike në punë.

Në tërësi nuk duhet të mbivlerësohet transferimi i njohurive profesionale dhe dijenisë për organizimin e punës: ngase edhe prej këtyre gjeneratave më të vjetra dhe më me përvojë profesionale pak prej tyre kthehen në Tetovë dhe vetëm një numër i vogël i tyre themelojnë biznes të vetin. Kthimi në vendlindje dhe veçanërisht investimet për themelimin e ndërmarrjeve janë të lidhura akoma me një shpenzim të madh të kohës dhe punës si edhe me ca reziqe.

Në fillim njëfar *brain gain* ndodhte edhe në arsimim. Kështu me anë të emigrantëve rrjedh në sistemin arsimorë të Tetovës një pjesë e dijenisë nga strukturat dhe proceset e sistemit arsimorë zviceran. Veç kësaj në ndërkohë në rajon, *Gjuha Gjermane* arrin një peshë të madhe dhe është tejet e përhapur.

Me sa duket shumë pak bartet në këtë rajon dijenia mbi sistemin politik zviceran apo mbi funksionimin e shtetit social. Të paktë janë ata emigrantë që pas kthimit të tyre në Tetovë angazhohen politikisht apo shoqërisht dhe që mundohen ti paraqesin përvojat dhe njohuritë e tyre shoqërore dhe politike.

Megjithatë në nivelin shoqëroro-politik ndodh një transfer burimesh/resursesh që nuk është për tu nënvlerësuar. Përvoja në Zvicër dukshëm i ndryshon qëndrimet e emigrantëve ndaj institucioneve shtetërore për aq, sa ata vetëdijshtëm i perceptojnë përparësitë e një shteti funksional juridik dhe u japin pëlqim të madh rregullave dhe përgjegjësisive. Ky ndryshim i qëndrimit bartet edhe tek anëtarëte familjes në rajonin prejardhës.

2.2.3 Strukturat rrjetore të pakta për transferimin e dijenisë

Përveç bartjes individuale me anë të emigrantëve të kthyer përgjithmonë pothuajse nuk ekzistojnë kanale apo rrejtat të tjera për transferimin e dijenisë mes emigrantëve tetovarë në Zvicër dhe banorëve të Tetovës.

Rrjetat përaktëse mund të shërbejnë ashtu, që Tetovarët/et të kualifikuar mirë të përfitojnë nga dijenia dhe ekspertiza jashtë vendit, thjesht duke mos u kthyer në vendlindje. Pikënisjet e mundshme janë: kooperacionet Univeristare ndërnacionale, rrejtat studentore dhe forma të ndryshme të rrejtave të ekspertëve.

Në këtë kontekst ekspertët u referohen mbështetjeve të mangëta institucionale për ndërtimin dhe përkujdesjen e strukturave përkatëse. Instancat shtetërore apo edhe NGO-të mund të kontribuojnë për përmisimin e transferimit të dijenisë me anë të rrjetëve.

2.2.4 Ndikimet rajonale –më tepër marignale- të transferimit të dijenisë

Për shkak të transferimit të mangët të dijenisë dhe ekspertizës nga Zvicra në Tetovë, ndikimet në rajon kanë një efekt më tepër modest. Në nivelin individual të emigrantëve të kthyer përgjithëmonë dhe në ndërmarrjet e tyre së bashku me bashkëpunëtorët/et mund të llogaritet me efekte positive. Ekspertiza profesionale e transferuar/e bartur ndihmon pa dyshim në shumë ndërmarrje për ndryshime në paga dhe për kualitetin e produkteve dhe me këtë për suksesin ekonomik. Gjithashtu duhet llogaritur me disa efekte të të nxënurit në ndërmarrjet konkurente të degës së njejtë.

Mezi hasen shenja, se migrimi ka një influencë ndaj vendit të hulumtuar, Tetovës. Gjithësesi emigrantët tetovarë dhe ato të kthyer në vendlindje mund të karakterizohen krejtësisht për bartjen e një ndikim pozitiv ndaj situatës arsimore në përgjithësi. Këtu dijenia dhe ekspertiza e transferuar luajnë më pak rol se sa mbështejta ekonomike e emigrantëve për arsimimin e anëtarëve të tyre të familjes. Gjithashtu një ndikim pozitiv ndaj situatës arsimore ka rritja e rëndësisë së arsimimit në shoqëri, e karakterizuar në përgjithësi nga emigrantët dhe nga emigrantët e kthyer përgjithmonë. Sipas mendimit të ekspertëve për rritjen e nivelit të arsimimit në rajon nuk janë faktorë emigrantët, por absolvimi obligativ i shkollës së mesme dhe themelimi i dy Universiteteve.

2.3 Ndikimet e shumta socio-kulturore me anë të rrejtave ndërnacionale

Ndryshe nga prapaveprimet modeste në fushën e transferimit të arsimimit dhe dijenisë në Tetovë, migrimi i popullatës shqipëtare në kontekstin socio-kulturor ka ndikim të tepërt ndaj rajonit prejardhës. Mënyrat e reja për komunikim dhe rrejtat ndërnacionale luajnë një rol eminent në përvojat e migrimit të familjeve.

Këto veprojnë si transmetues të ndikimeve socio-kulturore. Si ndryshime të spikatura, si pasojë e migrimit, personat e intervjuar i numëruan modernizimin e stilit jetësorë dhe ndarjen e roleve në strukturat familjare tradicionale. Këto ndryshime u përkasin edhe anëtarëve të familjeve në Tetovë edhe emigrantëve të kthyer përgjithmonë. Ata që përfitojnë nga këto ndryshime si dhe nga ndërnacionalizimi i mardhënieve janë para se gjithash të rinjtë e gjeneratës së dytë. Me anë të migrimit pasurohen dhe zgjerohen vështrimet në të ardhmen dhe perspektivat jetësore të emigrantëve të kthyer përgjithmonë dhe të anëtarëve të tyre të familjeve.

Me rritjen e mundësive për udhëtim dhe me format e reja të komunikimit, në mënyrë tendencioze kalohet në një çkufizim hapisnorë dhe kohorë mes vendit prejardhës dhe atij të huaj/të shpërnguljes. Anëtarët e familjeve mbrenda gërshetimit të lidhjeve ndërnacionale faktikisht jetojnë në dy bota të përditëshmërisë njëkohësisht dhe poashtu intensifikohen marrëdhëniet mes këtyre dy vendeve. Pamvarsisht nga ajo se emigrantët qëndrojnë një kohë të gjatë në Zvicër, me rajonin prejardhës të Tetovës vazhdojnë të jenë të lidhur emocionalisht, por njëkohësisht ritet një lidhje emocionale edhe me Zvicrën. Identitetet luhatëse, që jetojnë në dy botërat e ditëpërditëshmërisë- këto forma përfundimtare të një karakteri të ri të lidhjeve shoqërore në rrejtet ndërnacionale, formojnë resurse të rëndësishme shoqërore dhe kulturore të një jete në migrim dhe me migrim, që përdoren në mënyra të ndryshme nga anëtarët e familjeve të emigrantëve të intervjuar si dhe nga emigrantët e kthyer përgjithmonë.

2.3.1 Ndryshim në sturkutat familjare tradicionale- Gratë si shembull

Edhe pse akoma vlerësohen shumë formacionet familjare tradicionale dhe kohezioni i fortë për shkak të ngarkesës nga migrimi, sturkutat familjare shqiptare ndryshohen, posaçërisht në mjediset qytetare. Kjo shfaqet veçanërisht në ndryshimet e vetëkuptueshme të grave, që në të vërtetë shpesh marrin përsipër përgjegjësi dhe punë enorme si nëna që i rritin fëmijët vetë.

Me përmisimet ekonomike për shkak të migrimit, për më tepër gratë marrin pjesë në shumë procese për marrje të vendimeve, ato përmbajnë përgjegjësinë për buxhetin familjar dhe marrin pjesë në vendimet lidhur me edukimin dhe arsimimin e fëmijëve. Disa nga gratë e intervjuara theksojnë, se ndjehen me autonome dhe munden të lëvizin lirshëm në publik. Në ndeshje me paramendimet tradicionale, vlerë të madhe i kushtohet arsimimit të vajzave. Vajzat nga familjet emigrante për dallim nga më parë, tani kanë qasje të vetëkuptimshme për arsimim dhe studim. Anëtarët e familjeve janë shumë të vetëdijshëm për rëndësinë e arsimimit dhe gjithashtu e miratojnë rritjen e barazisë gjinore.

Një ndryshim themelor të roleve shohin personat e intervjuar para se gjithash në angazhimet profesionale të grave. Shumica e grave theksojnë se sot në Maqedoni roli tradicional i gruas si amvise është e kaluar dhe se ka depërtuar „modernizimi“. Gruaja shihet si një partnere e barabartë, modeli i roleve është ndryshuar dhe nuk duhet të jetë automatikisht patriarkal. Kështu në mes të grave të intervjuara ka gra që nuk kanë emigruar jashtë, por që janë të angazhuara, punojnë dhe bëjnë karrierë në Tetovë. Ky proces gjithësesi nuk është i përmbyllur dhe akoma është kontradiktorë. Kështu disa persona të intervjuar i brengos rënia e numrit të natalitetit. Planifikimi i familjes është ndryshuar dhe i afrohet modelit të familjeve të vogla si në perëndim. Pozita e familjes si institucion shoqëror qenka duke rënë.

2.3.2 Perspektivat e zgjeruara jetësore për të rinjtë

Të rinjtë, që në familjen e tyre e kanë ndjejtë migrimin, një pjesë e tyre bile që e kanë ndjejtur si proces të dhimbshëm, p.sh. Mungesa e babait vite me radhë - prapëprap zhvillojnë plane të reja jetësore lidhur me migrimin- për shembull për arsimin e tyre udhëtojnë/ vejinë mes këtyre dy shteteve. Personat kyç referohen

në atë, se ata u qëndrojnë përball ndikimeve që vinë nga jashtë dhe se me kthimin e emigrantëve në vendlindje „kultura e perendimit“ bartet si një frymë e re. Komunikimi me emigrantët rezulton me pranim të madh të risive, të ndryshimeve dhe shpion në thyerje të traditave të deritanishme.

2.3.3 Remitanca shoqërore që vijnë si rezultat i identifikimit të emigrantëve me vendin ku kanë emigru

Nga rezultatet e intervistave mundet të konstatohet, se me anë të emigrantëve rrejdhin nga vendi që i ka pranuar ato në vendin nga e kanë prejardhjen, remitanca shoqërore në formë të normave të reja të përshtatura, mënyrave të sjelljes, identifikimeve, dhe në formë të ndryshimeve të stilit dhe qëndrimeve jetësore. Pjesërisht familjet në vendlindje identifikohen me vlerat e anëtarëve të tyre të migruar. Përpikshmëria, rregullsia, efikasiteti, koha si një pasuri e vlefshme, disiplina në punë, vetëkuptueshmëria e funksionimit të një shteti juridik dhe korrektësia e proceseve institucionale vlerësohen dhe pranohen si cilësi tipike zvicëra.

2.3.4 Standardizimi i marrëdhënieve me migrimin

Katër rastet e paraqitura në vijim janë shembuj të tipeve të ndryshme me të gjitha dallimet në marrëdhënie me jetën në migrim dhe jetën me migrim. Këta, nga njëra anë tregojnë kontradiktat e proceseve të migrimit dhe anët e tyre frenuese, por i tregojnë edhe burimet/resurset, që konfirmojnë nevojën për një mbështetje strukturale dhe institucionale të pjesëmarrësve në këtë proces.

Studentët Drini Shabani dhe Lule Kastrati përfaqësojnë të rinjtë, që ritën me proceset e migrimit ndërnacional dhe që i shfrytëzojnë mundësitë për arsimim edhe në Zvicër edhe në Tetovë dhe që me ndërnacionalitetin e tyre i zgjerojnë perspektivat e tyre të së ardhmes. Ata i njohin kulturat dhe mentalitetet në të dy „botërat“ dhe vendosin me vetëdije të plotë të jetojnë në vendlindjen e tyre Maqedoni.

Të rinjtë që kanë ngelur në vendlindje Vesa Imeri dhe Ilir Gashi për shkak të përvojës së dhimbshme të ndarjes shkaku i migrimit, ato ardhmërinë e tyre e shohin kryesisht në Tetovë. Ata njëkohësisht me emigrimin e prindërve kanë fituar një pikënisje të mire dhe mundën të absolutojnë një studim në Tetovë apo të guxojnë të zgjedhin rrugën për pamvarsimin e tyre.

Bashkëshortja dhe nusja Fatmire Elshani, poashtu nga ndarja tepër e dhimbshme dhe nga ngarkesa për të rritur fëmijët vetë në Tetovë, vjen në përfundim se, për atë familja është strehimi më i rëndësishëm. Pamvarsisht nga disa ndryshime në rolin të sajë, ajo paraqet gruan e një mjedisi tradicional, konservativ dhe me disavantazhe në arsimim. Fëmijët e sajë mundën në të vërtetë të jetojnë një jetë më moderne, vajzat guxojnë të studiojnë. Ajo vetë e vlerëson përmisimin e gjendjes ekonomike, është më krenare dhe më e pamvarur nga gratë tjera, që nuk kanë një të kaluar me migrim. Por këtu ajo thekson se, kjo situatë nuk ia zavendëson të shoqin e sajë. Tani shpreson për një jetë më të mirë për fëmijët e sajë në Tetovë, ngase për këtë prindërit e këtyre fëmijëve u sakrifikuuan me shpëputje nga njëri tjetri.

Përfundimisht *emigranti i kthyer Blerim Ismailii*, paraqet ngritjen shoqërore të një emigranti tetovarë, që pas disa viteve angazhimi profesional jashtë vendit, në vendlindjen e tijë bën karrierë. Ai mburret me arritjet e tija dhe në migrim e sheh çelsin e ngritjes shoqërore. Ai e zbaton dieninë e tijë ndërnacionale dhe e transmeton atë në vendlindjen e tijë.

3 Mendime dhe këshilla

Studimi ka treguar se, duke patur parasysh tendencat për zhvillimin sociokulturor të përshkruara më lartë, nuk shfrytëzohen sa duhet resurset ekzistuese të emigrantëve shqipëtarë. Shumë emigrant që konsiderojnë të kthehen në vendlindje dhe të ndërtojnë një ndërrmarjeje atje, shkakun i kushteve të vështira për investim ata hezitojnë ta bëjnë këtë. Mirëpo gjithashtu ekziston nevoja për përmisimin e transferimit të dijenisë dhe ekspertizës. Duke mos dashur të mbivleroshet potenciali i emigrantëve tetovarë në Zvicër, mundet të supozohet, se me marrjen e masave për përmisim dhe për mbështetje, më tepër burime/resurse do të rrjedhin në Tetovë dhe e tërë kjo do të rezultonte me një ndikim më të mirë në rajon.

3.1 Politika migruese maqedonase

Me sa duket në fushën politike nuk ekziston asnjë strategji (apo ajo nuk zbatohet) se si duhet të trajtohet procesi i migrimit dhe i kthimit nga migrimi. *Më me rëndësi do të ishte që në formimin e politikës migruese të inkudarohen aktivisht emigrantët dhe emigrantët e kthyer përgjithmonë. Kjo kushtëzon një kooperim mes nivelit qeveritar shtetëror, rajonal dhe atij lokal.* Vetëm me marrjen parasysh të kërkesës së tyre specifike, mundësohet një shfrytëzim i mirë i potencialit ekonomik dhe shoqëror. Veç kësaj me involvimin e madh të emigrantëve dhe emigrantëve të kthyer rritet edhe gadishmëria e tyre të angazhohen në vendlindjen. Në suazat e partenritet migrues mes Zvicrës dhe Maqedonisë, munden në procesin e formimit të kësaj politike, institucionet shtetërore zvicrane si dhe enti federal për migrim apo direksioni për zhvillim dhe bashkëpunim të ndërmarrin funksione të rëndësishme ndërmejtësuese. Një rol qendror mund ti takojë edhe MARRI¹ (Migration, Asylum, Refugees Regional Initiative), një institucion i etabluar mirë në rajonin e Ballkanit perëndimor, që merret me çështjet migrimit rajonal dhe internacional. Gjithashtu një partner kompetent, e i rëndësishëm për këtë proces do të ishte edhe agjencioni për migrim-Agency of Emigration i qeverisë së Maqedonisë.

Lidhur me këtë, duhet me këtë studim të tërhiqet vërejtja, se ende ekzistojnë tensione ndëretnike mes grupit të popullatës shqipëtare dhe maqedonase. Prandaj përpjekjet për kundërveprimin e këtyre tensioneve janë edhe më tej të rëndësishme.

3.2 Fusha ekonomike

Nga ana e emigrantëve u bë e qartë se lidhur me angazhimet për investim apo planet për investim, ka nevojë të madhe për një ofertë me informacione apo këshilla si dhe për struktura të përshtashme për këmbimin e ideve dhe përvojave.

Tanimë, kur emigrantët ndodhen për pushime në vendlindjet e tyre, në disa vendbanime shfaqen *takime mes përfaqësuesëve të vendbanimeve dhe emigrantëve.*

¹ <http://www.marri-rc.org/>

Në këto takime munden emigrantët para kohe të marrin informata lidhur me mundësit për investim. Gjithësesi këto takime përcillen me vetiniciativë dhe ndodhin vetëm në mënyrë sporadike.

Do të ishte e arsyeshme, posaçërisht emigrantëve dhe emigrantëve të kthyer në vendlindje në qendra/zyra të pajisura, nga ana e një stafi profesional, të vihen permanent në dispozicion informata për kushtet e përgjithshme ligjore për investime, për proceset administrative si dhe informata për mundësit për investim dhe bashkëpunim. Pasi që disa vednbanime për të udhëhequr një zyrë apo qendër të tillë, mezi se disponojnë me resurse personale dhe financiare, do të ishte e arsyeshme, për tërë komunën e Tetovës të krijohet një qendër/zyrë e përbashkët.

Kjo do të mundej ti bashkangjitej njëris njësi administrative tanimë ekzistuese në komunën e Tetovës. Gjatë konceptimit të kësaj qëndre apo zyre do të munden tu rrinë krahu duke i mbështetur enti federal për migrim BFM, direksioni DEZA, gjithashtu edhe instituti MARRI si dhe organizata internacionale për migrim (IOM). Gjithashtu do të ishte e arsyeshme të bëhet një ofertë për këshilla apo informacione për emigrantët në Zvicër, si që bëhet tanimë në suaza të ndihmës për emigrantët e kthyer nga ana e entit federal për migrim BFM në bashkëpunim me direksionin DEZA, IOM dhe zyrave përgjegjëse të kantoneve dhe qendrave për ndihmë. Nga ana Zvicërene si partner do tishin të pranueshëm edhe financierët për zhvillim të angazhuar në Maqedoni SIFEM (Swiss Investment Fund for Emerging Markets) dhe SECO Start-up Fondi.

Një internet-platfomë do të ishte gjithashtu e përshtatshme si arkë komunikimi dhe informacioni. Kështu që emigrantët nga Zvicra do të mundeshin në çdo kohë të marrin informacione aktuale. Gjithashtu të përfytyrueshme janë hapat e para administrative me anë të online-formulareve, njëkohësisht për këto hapa të para emigrantët do të ishin më mirë të mbrojtur nga korrupsioni. Platforma do të mundet të furnizohet me informacione nga ana e të gjithë pjesëmarrësve (si p.sh. nga emigrantët, emigrantët e kthyer në vendlindje, ndërmarrësit, administrata nacionale dhe lokale, bankat, NGO-të, organizacionet për zhvillim dhe financierët për zhvillim) dhe njëkohësisht do të mundej të tërhiqen informacione të nevojshme prej tyre. Platformën do të mund ta plotësoj forumi për diskutime për këmbimin e përvojave dhe ideve si dhe rrjetëformimi (netowrking) për synimet e përbashkëta për investim. Kjo webfaqe do të mund të bashkangjitet në webfaqen qeveritare lokale (p.sh. webfaqen e komunës së Tetovës) apo asaj nacionale (p.sh të agjencionit për migrim - Agency of Emigration). Enti federal për migrim BFM, direksioni DEZA, si edhe instituti MARRI përsëri do të munden të ndihmojnë gjatë konceptimit të internet-platfomës, gjatë mbledhjes së pjesëmarrësve dhe implementimit teknik.

Para krijimit të qendrave/zyrave dhe para krijimit të internet-platfomës shfaqet *orgainzimi dhe zbatimi i një takimi* si një fillim adekuat për ti bashkuar pjesëmarrësit relevant dhe për të diskutuar aspektet dhe nevojat e ndryshme lidhur me investimet e emigrantëve.

Te rëndësishme janë informacionet për mundësitë e transferimit të parave në Zvicër dhe në Tetovë.

Oferta informacionesh si p.sh. Broshurat e SECO („Transferim i parave nga Zvicra në vendet jashtë. Një broshurë me informacione për emigrantët dhe emigrantet.“) shërbejnë, që emigrantët të mundin të informohen për mundësitë për transfere të volitshme dhe të sigurta.

Për të arritur atë, që emigrantët të angazhohen në projekte më të mëdha për investim, një instrument i përshtatshëm do të mundej të jetë mbështetja institucionale e një grupi investimesh.

Në programin „Tres por uno“ (tre për një) në Meksikë për shembull, qeveritë shtetërore, rajonale dhe lokale për çdo dollar, të investuar nga Meksikanët që jetojnë në SHBA në projektin për zhvillim të miratuar nga ana e njëres nga qeveritë në vendlindje, vënë në dispozicion tre dollar.

Për shmangien e pengesave për investim në Maqedoni tanimë ndërmeren shumë hapa (programet OECD dhe SECO). Autorët e këtij studimi kërkohet përsëri ta tërheqin vëmendjen për atë, se nga ana e personave të pyetur si problem qendrorë dhe pengesë e madhe për zhvillimin e rajonit konsiderohen proceset e stërzgatura burokratike dhe korrupsioni dukshëm i përhapur. Kështuqë akoma ekziston nevoja të veprohet në këtë fushë.

Lidhur me organizimin e planeve për investim të emigrantëve duke u mbështetur në studimin e paraqitur nuk mundet të nxirren tendenca të qarta. E arsyeshme është sigurisht investimet të mbështeten në tregje të veçanta. Nga disa biseda rezultoi, se mbrenda bashkësive tetovare në Zvicër ekziston një far kërkese për produkte nga Tetova.

3.3 Dijeni dhe njohuri profesionale- Know-how

Me anë të emigrimit dhe remigrimit rrjedh në vendlindje në përgjithësi shumë pak dijeni me kualifikim të lartë. Rrjetat ndërnacionale për dijeni do të mundin të rritin rrejtjen e burimeve/resurseve, duke mos qenë e domosdoshme emigrantët me kualifikim të lartë të kthehen në vendlindjet e tyre. Prandaj është e arsyeshme të mbështeten strukturat e tilla, si p.sh. të mbështeten me anë të projekteve për kooperim mes shkollave të larta dhe Universiteteve zvicërene dhe tetovare (mbledhje, seminare, ndërtimi i rrejtit për kontakte, bashkëpunim mes organizatës studentore shqipëtare në Zvicër dhe organizatës studentore në Tetovë) apo të ndërtohen internet platforma.

Studimi ka treguar, se në rajon rrjedh kryesisht njohje praktike profesionale. Kjo njohje profesionale qëndron gjithësesi në ndërmarrjet e emigrantëve të kthyer, kështu që nga kjo në përgjithësi rajoni shumë pak përfiton. Për ta bërë këtë njohuri profesionale të arritshme edhe për qarqet tjera, duhet të diskutohet me ndërmarrjet përkatëse për format për bashkëpunim. Me forma mendohen: seminarët, trajnime apo ndarja e vendeve për praktikë në ndërmarrje përkatëse.

Shfaqet nevoja të veprohet në çështjen lidhur me emigrantët e rinjë të kthyer (përkohësisht) në vendlindje dhe që dëshirojnë kualifikimin e tyre të ulët arsimorë në Zvicër ta përmirësojnë në Tetovë.

Të rinjë, të cilët për këtë arsye mendohen të kthehen në vendlindje, duhet me kohë të këshillohen për opcionet e tyre afatgjate në Zvicër dhe në Maqedoni. Në këto rrethana më mirë është pas mbarimit të shkollës në Zvicër të absolvohet një shkollë profesionale, se sa direkt pas mbarimit të shkollës të kthehen në vendlindje që atje të absolvojnë gjimnazin dhe më pas të studiojnë në Universitet. Ekziston rreziku, pas mbarimit të studimeve, mos gjejnë punë dhe poashtu të kenë vështirësi me akreditimin akademik të diplomave Universitare në vendet perendimore.

Studimit të paraqitur mundet ti bashkëngjitet një projekt pasardhës, në të cilin projekt do të vështrohen perspektivat arsimore dhe profesionale të tetovarëve të rinj në Zvicër si dhe potenciali i këtij orientimi ndërnacional. Këtu bëhet fjalë nga njëra anë për përfshirjen e problemeve dhe nevojave specifike të tetovarëve të rinj në Zvicër, lidhur me perspektivat e tyre arsimore dhe profesionale. Me punë duhet të nxirret se në cilat rrethana dhe me cilat motive mendojnë të kthehen (përkohësisht) tetovarët e rinj në Tetovë dhe cilët reziqe ndërlidhen me këtë. Nga ana tjetër duhet të ekzaminohet potenciali i orientimit të tillë ndërnacional. Eventualisht mundet të përshkruhen format tanimë ekzistuese për bashkëpunim apo projekte ndërnacionale dhe të indentifikohen metodat më të mira, apo metoda për sukses të ashtuquajtura Best-Practice-modele.

Në disa shkolla të Maqedonisë tanimë ofrohet edukimi mbi ekologjinë dhe mbështetet nga dierksioni DEZA. Studimi ka treguar se, me anë të përvojave të tyre, emigrantët kanë një vetëdije të dallueshme ekologjike të përfituar nga Zvicra dhe janë bartës të vlefshëm të dijenisë dhe „Ambasadorë“ në këtë rajon. Këtë dijeni dhe këto përvoja ia vlenë të bëhen të arritshme edhe për qarqet tjera në Tetovë.

Me studimin e prezentuar autorët paraqesin një analizë të hollësishme të proceseve të migrimit të një grupi më të madh mërgimtarësh shqipëtarë nga Tetova, që banojnë në rajonin Wintertur dhe në Zvicrën lindore. Mbrenda një intervali të gjatë kohor janë formuar rrjeta komunikimi mes emigrantëve në Zvicër dhe anëtarëve të tyre të familejeve në vendlindje. Me anë të partenrietit të shteteve do të mundeshin të vendosen mes Zvicrës dhe Tetovës lidhje institucionale në fusha të ndryshme (shoqërore, kulturore, arsimore etj.)

Bibliografi

- Bauer, T. et al. (2000). What are Migration Networks? Discussion Paper No. 200. Bonn: Institute for the Study of Labor (IZA).
- Dahinden, J.. (2005). *Pristina-Schlieren: Albanische Migrationsnetzwerke im transnationalen Raum*. Zurich, Switzerland: Seismo Verlag.
- De Haas, H. (2005). International migration, remittances and development: Myths and facts. *Third World Quarterly*, 26(8), 1269-1284.
- Faist, T. (2008). Migrants as transnational development agents: An inquiry into the newest round on the migration-development nexus. *Population, Space and Place*, 14, 21-42.
- Glick-Schiller et al. (1992). Towards a transnational perspective on migration: race, class, ethnicity, and nationalism reconsidered. New York: The New York Academy of Sciences..
- Levitt, P. (1998). Social remittances: Migration driven local-level forms of cultural diffusion. *International Migration Review*, 32(4), 926-948.
- Levitt, P., & Nyberg-Sørensen, N. (2004). The transnational turn in migration studies. *Global Migration Perspectives*, 6. Geneva, Switzerland: Global Commission on International Migration (GCIM).
- Pries, L. (2008). *Die Transnationalisierung der sozialen Welt*. Frankfurt am Main, Germany: Suhrkamp Verlag.